



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0518

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Limit L & B” SH.P.K me seli në Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave” me nr. të prokurimit:624-22-12145-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Suharekë, me datën 18.09.2023 mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “Limit L & B” SH.P.K. me nr. 2023/0518 , e datës 24/07/2023, kurse vendimi i AK Komuna Suharekë i datës 04.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave” me numër të prokurimit 624-22-12145-2-2-1, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2.Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 05.11.2022,Komuna Suharekë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Me datë 23.11.2022, ka publikuar Formularin Standard për Korrigjimin e Gabimeve të Tenderit. Me datë 29.11.2022, është bërë hapja e tenderit. Me datë 04.07.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin të prokurimit me titull: “Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave” me numër të prokurimit 624-22-12145-2-2-1,ku është rekomanduar për kontratë GOE: “Sinjalizimi” sh.p.k & "Cube Designers" L.L.C-Suharekë.

Me datë 10.07.2023, OE ankues “Limit L & B” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Suharekë, me datë 13.07.2023 AK Komuna Suharekë e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për shqyrtim, si dhe ka vërtetuar njoftimin e Autoriteti Kontraktues të datës 04.07.2023.

Me datën 24.07.2023 OE ankues “Limit L & B” SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 518/2023.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Kontrate publike kornizë - shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €. Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0274 i dt: 12.06.2023.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë 28 korrik 2023 me raportin e ekspertizës. AK- Komuna Suharekë me datë 28.07.2023, ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE ankues “Limit L & B” SH.P.K., me datë 31.07.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues “Limit L & B” SH.P.K., të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

- Mbetë në fuqi vendimi i AK, i datës 04.07.2023, (Njoftimi për dhënie të kontratës).

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Limit L & B” SH.P.K.

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, sikurse ka potencuar/elaboruar ne piken 1,2, 3 dhe 4 , Tek deklarata detale mbi faktet dhe argumente ne ankesën e tij të dorëzuar pran OSHP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, pretendimet ankimore te parashtruar ne ankesë tij tek dispozitat e shkelur nga AK dhe deklarata detale mbi faktet dhe argumentet, prandaj duke u bazuar në Rregulloren Nr. 01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë se pretendimet e palës ne ankesë nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), sqaron se po ashtu është nxjerre një Vendim lidhur me ketë aktivitet te prokurimit konkretisht Vendimi OSHP: 2023/0274 te datës 12.06.2023.

Kurse sa i përket pretendimit te OE ankues lidhur me Kontrata dhe “dokumentet” për gypa të zingtutar. krijojnë shumë dyshime:

- Data e kontratës është 15.04.20016, pra duhet prit edhe 17.993 vite për tu realizu ?!!!!
- Kontrata nuk ka protokoll arkivor nga prodhuesi një nga fabrikat e mëdha në Maqedoninë Veriore që mban dhe udhëheq protokoll;
- Nuk ka asnjë CMR të vulosur për pranim nga blerësi,
- Nuk ka asnjë Dud Doganor të Republikës së Kosovës si dhe dëshmi se malli është doganuar dhe ka hyrë në Kosovë.

Eksperti shqyrtues sqaron, se AK ka respektuar vendimin e OSHP-se nr. 2023/0274 te datës 12.06.2023, duke kërkuar sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ndërsa përgjigja dhe dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontrate kanë qenë te pranueshme për Komisionin e vlerësimit, si dhe janë ne pajtim kerkesen6/deshmin6 të FDT-së, pasi qe pretendimet e OE ankues nuk janë te definuar/sqaruara saktë, qarte si dhe këto pretendime nuk kane qene kërkesa të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate, dhe AK-komisioni i vlerësimit ka vepruar sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te FDT-se dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Ndërsa lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, se OE Sinjalizimi ofron një Kontrate me një kompani nga Republika Srpska, Banjalluka, SACOM sh.p.k., por kjo Kontrate nuk dëshmon se lëndë e kontratës është PRODUKTI FOLJE 3 M ne asnjë nen. Po ashtu kjo Kompani, SACOM sh.p.k., paraqet një Certifikatë të lëshuar në

Zvicër në Maj të vitit 2020. Por validiteti kësaj Certificate është një vit , Pra Dokumenti ka Skadencë me shume se 24 muaj. Kjo tregon se edhe ne këtë kërkesë OE Sinjalizimi nuk ka ofrua dokumentacion valide.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si në vijim:

Kërkesat: Kërkesa 9 - Marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të prodhuesit të foljes 3M EGP dhe DG	Evidencat: Dëshmia 9-Marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të prodhuesit te foljes
---	--

GOE i rekomanduar për dhënie te kontratës lideri i grupit “Sinjalizimi” Sh.P.K., ka dorëzuar distribution agreement -me kompaninë “SACOM” d.o.o.. Bosnia Hersegovina si distributor i ai autorizuar për territorin e Kosovës. Prandaj nëse e analizojmë kërkesa 9/dëshminë 9 të FDT-së si më lartë, atëherë vërehet se në kërkesë është kërkuar vetëm marrëveshja me prodhuesin/distributorin, prandaj bazuar ne dokumentet e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate e plotëson kërkesën dhe dëshminë të përcaktuar ne FDT (po ashtu është ne diskrecion të AK-së të vlerësoj, ekzaminoj dhe krahasoj tenderët të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore të LPP-së). Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pikë nuk është i qëndrueshëm.

Po ashtu, lidhur me pretendimin në këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me date 10.07.2023, kurse ZPP me date 13.07.2023 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke vepruar ne pajtim te plotë me nenin 108/A paragrafi 12 të LPP-së, ku thotë:

“kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtuesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”, mirëpo bazuar ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, janë përshkruar ne gjuhen e fakteve dhe argumenteve - provave por jo duke u bazuar ne dispozita ligjore te LPP-së, si dhe me rastin konkret përveç parashtuesit të ankesës vendimi mbi refuzimin e KPR nuk janë njoftuar të gjitha palët e interesa lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshëm.

Po ashtu, lidhur me disa pretendimet te OE ankues tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me disa pretendime ankimore te parashtuar nga OE ankues dhe që nuk janë ne fushën/përgjegjësin dhe kompetencën e ekspertit shqyrtues te trajtohen, andaj lidhur me ato pretendime OE ankues mund te ju drejtohet organeve kompetente për trajtimin e tyre.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK–Suharekë, komisioni i vlerësimit, ka respektuar nenin 7, 59, dhe 60 të LPP-së, andaj, Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit-ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore te LPP-së, ne këtë aktivitet të prokurimit, ne mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje të tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuara (për arsyen që u cek tek përgjigjet në pretendimet si më lartë), dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues që të mbete në fuqi vendimi i AK, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime me pohimet ankimore.

Prandaj Paneli pjesërisht i mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij, dhe nuk gjenë mbështetje vetëm sa i përket pretendimit të dytë lidhur me pohimin e ankuesit për përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë ku në ofertën e tij

ofron një Kontrate me një kompani nga Republika Srpska , Banjalluka, SACOM sh.p.k., por kjo Kontrate nuk dëshmon se lëndë e kontratës është PRODUKTI FOLJE 3 M ne asnjë nen. Po ashtu kjo Kompani, SACOM sh.p.k., paraqet një Certifikatë të lëshuar në Zvicerr në Maj të vitit 2020. Por VALIDITETI kësaj Certifikate është një vit , PRA DOKUMENTI KA SKADENCE me shume se 24 muaj. Kjo tregon se edhe ne këtë kërkesë OE Sinjalizimi nuk ka ofrua dokumentacion valide. Me çrast eksperti shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si të pa bazuar për shkak se sipas nenit 59 të LPP vlerësimi i ofertave duhet të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit. Paneli nga një prespektiv tjetër dhe në frymën e parimeve ligjore mendon ndryshe nga eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se AK ka qenë dashtë se këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit sa i përket kësaj marrëveshje ta kërkoj që të jetë valide, por me qenë se këtë nuk e ka kërkuar dhe me qenë se në ofertën e OE ankues është marrëveshja dhe certifikata, atëherë paneli shqyrtues konsideron se AK konform nenit 72 të LPP të kërkoj sqarime shtesë sa i përket validitetit të kësaj marrëveshje , ngase në të kundërtën do të bie ndesh me nenin 1, 6, 7, 56.3 dhe 59 të LPP. Ngase, duke u bazuar në dispozita ligjore, se AK duhet ta ketë parasysh se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 59 të LPP, i cili në paragrafin 4, citon: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*, si dhe konform nenit 56 të LPP, i cili në paragrafin 3, citon: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."*, andaj vlerësimi më i mirë dhe më i drejtë sipas panelit shqyrtues është që AK ta shtij në përdorim nenin 72 të LPP.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbënë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: *"...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji"*.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: *"Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..."* Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplisit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - . Limit L & B SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: